



FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
ALBANIAN DEVELOPMENT FUND



KOMUNA QENDËR

PLANI I ZHVILLIMIT TË KOMUNËS QENDËR





**PLANI I ZHVILLIMIT
TË KOMUNËS
QENDËR**

Fjala e kryetarit të komunës

Kam nderin e veçantë të përshëndes dhe të falenderoj në këtë hyrje të dokumentit të Planit të Zhvillimit Lokal, të gjithë banorët, gratë dhe burrat, të rinjtë e të moshuarit, intelektualët, bizneset, stafin dhe këshillin e komunës Qendër, të cilët së bashku me ne, patën rastin e veçantë të merrnin pjesë në një proces shumë të rëndësishëm për të ardhmen tonë. Përzgjedhja e Komunës Qendër për përgatitjen e Planit të Zhvillimit Lokal, nga projekti i Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në muajin mars 2008, u mirëprit me shumë entuziazëm. Shqetësimi ynë më i madh ishte t'i përgjigjeshim çdo kërkesë për të zbatuar me sukses procesin në çdo hap të tij. Përfshirja në projektin e hartimit të Planit të Zhvillimit Lokal ishte një sfidë e vërtetë për të cilën jam i bindur se do të na çojë doemos në zhvillime të reja dhe shumë shpejt komuna jonë do të jetë pjesë integrale e qytetit të bukur të Fierit, duke zbutur dallimet midis jetës në qytet dhe asaj në fshat, përmes përmirësimit të kushteve të jetesës dhe ofrimit të shërbimeve cilësore. Qytetarët e komunës sonë me vitalitetin dhe potencialin që ata mbartin e meritojnë që të bëhen pjesë e planifikimit të së ardhmes së tyre, dhe ta ndiejnë veten krenarë para fëmijëve dhe brezave të ardhshëm për kontributin që ata po japin sot. Plani i Zhvillimit Lokal është një dokument i rëndësishëm, i cili do ta orientojë komunën në sfidat për të përmirësuar jetën e banorëve të saj. Nisur nga sa më sipër, angazhimi ynë i përbashkët në këtë proces ka qenë maksimal. Masat e realizuara, interesi që është treguar, ndihma profesionale e specialistëve të FSHZH, performanca, potencialet njerëzore, ekonomike dhe progresi në mirëqeverisje, na bindin se jemi të aftë dhe gati për t'u përballur me të ardhmen dhe me detyrat që do të na dalin përpara. Përgatitja e Planit të Zhvillimit Lokal në Komunën Qendër, mori përmasat e një fushate të rëndësishme, pasi, së bashku me stafin e këshillin komunës, dhe kryetarët e fshatrave realizuam me përgjegjësi të gjitha detyrat e lëna në takimet e grupit të punës. Këto sollën një dokument cilësor të PZHL i cili do të mbajë firmën e të gjithë banorëve të komunës. Hartimi i PZHL për komunën tonë u realizua me pjesëmarrjen e komunitetit në të gjitha fushat e tij prioritare. Ndjekja hap pas hapi e metodologjisë dhe përfshirja e të gjithë aktorëve, na dha prodhimin e një dokumenti të pranueshëm, që përfaqëson interesat e të gjithëve dhe që u aprovua njëzëri nga këshilli i komunës. Ky dokument do t'i shërbejë për një kohë të gjatë komunës në planifikimet që ajo bën për realizimin e projekteve. Deklaroj me kënaqësi e siguri të plotë se kemi hartuar një plan zhvillimi cilësor e ambicioz dhe se kemi kryer një shkollë për të qeverisur më mirë të gjithë së bashku. Unë vlerësoj maksimalisht punën e mbeshtetjen e stafit të FSHZH për hartimin e PZHL, të cilët i falenderoj me kënaqësi, si dhe jemi të hapur për bashkëpunime të tjera frytdhënëse për të rritur kapacitetet dhe për të investuar në komunën tonë. Shpresoj dhe kam bindjen se bashkëpunimi i sukseshëm do të pasohet nga bashkëpunimi për realizimin e projekteve që kemi përcaktuar, që ato të kthehen në vlera reale dhe së bashku të ndiejmë zhvillimin dhe një jetë më të mirë për të gjithë.

Me respekt,
Harilla MILE

Tabela e Përmbajtjes

SHOQËRIA (KAPITALI SOCIAL)	16
a. Komuniteti dhe dinamika	16
b. Arsimimi	17
c. Kultura dhe koha e lirë	18
d. Shërbimi shëndetësor	20
e. Asistenca sociale	20
f. Cilësia e jetës	21
EKONOMIA	22
a. Situata e përgjithshme	22
b. Blegtoria	24
c. Bujqësia	25
d. Telekomunikacioni dhe Teknologjia Informuese	26
MJEDISI DHE INFRASTRUKTURA	26
a. Pozita gjeografike e komunës	26
b. Burimet natyrore	27
c. Sistemi rrugor	29
d. Furnizimi me energji elektrike	30

e. Furnizimi me ujë të pijshëm	30
f. Kanalizimi i ujërave të zeza dhe të bardha	31
QEVERISJA E KOMUNËS	32
a. Organika e komunës	32
b. Buxheti i komunës	34
c. Pjesmarrja qytetare	36
I. Deklarata e vizionit	38
II. Qëllimet Strategjike	39
III. Hapat e veprimit	40
Zhvillimi Ekonomik	40
Zhvillimi Social	47
Zhvillimi i Infrastrukturës dhe Shërbimeve Publike.....	53
Qeverisja e mirë.....	58
IV. Fishat e Projekteve.....	62
Local Development Plan - Qendër	78

Plani i Zhvillimit Lokal i Komunës Qendër, Fier, është përgatitur nga grupi i Planit të Zhvillimit Lokal të krijuar në komunë, me asistencën teknike të ofruar nga Njësia e Planeve të Zhvillimit Lokal, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Metodologjia

Tashmë, u bënë vite që FSHZH është identifikuar si një nga aktorët kyç në hartimin e planeve strategjike të njësive të qeverisjes vendore. Kjo përpjekje është në vazhden e angazhimit të FSHZH për të ngritur kapacitetet e njësive të qeverisjes vendore dhe komuniteteve lokale.

Pse Duhet të Hartojmë një Plan për Zhvillimin Lokal?

Planifikimi i zhvillimit lokal është një proces që i jep mundësi qeverisjes lokale dhe banorëve që ajo përfaqëson - të kontrollojnë dhe të hartojnë të ardhmen e tyre. Një Plan Zhvillimi Lokal jep informacion mbi drejtimin e veprimeve drejt zhvillimit të një komuniteti. PZHL është një hartë për t'u ndjekur nga të zgjedhurit, personeli i komunës, dhe komuniteti në tërësi, për t'i dhënë formë të ardhmes së dëshiruar prej tyre. Planifikimi i Zhvillimit Lokal ka të bëjë me të menduarin, të vepruarin dhe parashikimin strategjik të veprimeve që duhet të ndërmarrim, në mënyrë që të realizojmë qëllimet e dëshirueshme.

Një plan zhvillimi është efektiv kur, qeverisja lokale kupton se çfarë po bën, kujt i shërben, dhe sa mirë i plotëson nevojat e komunitetit. Kur bëhet mirë, planifikimi i zhvillimit lokal ka pjesëmarrjen e gjerë të komunitetit dhe aktorëve të tjerë të interesuar. Kjo garanton që gjatë procesit po përdoren burimet më të mira të mundshme në planifikimin e së ardhmes ashtu si edhe krijon një forum të gjerë për pjesëmarrje të shoqërisë, përkushtim dhe rritje të ndjenjës së pronësisë.

Qëllimet strategjike dhe hapat e veprimit, të shprehura në Planin e Zhvillimit Lokal, nuk janë vetëm autoriteti i qeverisjes vendore. Komuna nuk mund të bëjë vetë gjithçka, dhe as nuk mund t'i adresojë vetëm të gjitha problemet e komunitetit. Kështu që, në Planin e Zhvillimit Lokal është idea që i gjithë komuniteti ka një kontribut për të dhënë në arritjen e një komune të qëndrueshme. Angazhimi dhe veprimet e komunitetit, grupeve dhe të interesuarve të tjerë janë mjaft të rëndësishme në arritjen e suksesshme të Vizionit të Komunës, qëllimeve dhe veprimeve që janë themelore në Planin e Zhvillimit Lokal. Një PZHL është efektiv kur në mënyrë rigoroze përdoret që të planifikojë shërbime dhe projekte, identifikojë burimet, boshllëqet dhe nevojat financiare, të masë rezultatet e punës së qeverisë lokale, dhe t'i komunikojë këto rezultate tek komuniteti. Ky është një proces dhe dokument me anë të të cilit komuniteti mund të vërë përpara përgjegjësisë të zgjedhurit në mënyrë që t'i përgjigjet nevojave dhe prioriteteve të tij.

PZHL siguron një përdorim efektiv të burimeve specifike të komunës në mënyrë që të bëhet sa më e mundur arritja e objektivave.

Metodologjia e FSHZH rreth Planifikimit me Pjesëmarrje të Zhvillimit Lokal përpiqet të përmbushë këtë premtim. Metodologjia dhe struktura përmban parime udhëzuese, strukturën, komponentët dhe pjesëmarrësit e mëposhtëm për një përjasje gjithpërfshirëse dhe fizibël të planeve të zhvillimit lokal në komuna.

Parimet Udhëzuese të Planeve të Zhvillimit Lokal në Komunitet e Shqipërisë

Plani i Zhvillimit Lokal të Komunës është:

Strategjik. PZHL sheh drejt nevojave afatgjate të një komuniteti dhe identifikon strategjinë më të mirë për t'i adresuar këto nevoja; në mënyrë strategjike vlerëson burimet, dhe shpërndarjen më të mirë të këtyre burimeve në funksion të zgjidhjes së problemeve që shqetësojnë komunitetin. Ky proces krijon midis pjesmarrësve edhe kulturën e të menduarit në mënyrë strategjike që është një faktor i rëndësishëm për qëndrueshmëri të suksesshme.

I thjeshtë. Metodologjia dhe procesi i PZHL/MVP do të jenë të kuptueshme dhe të manaxhueshme për komunitet në lidhje me fizibilitetin, pronësinë dhe qëndrueshmërinë.

Pjesmarrës dhe Përfshirës. Procesi i hartimit të PZHL/MVP, zbatimi dhe monitorimi i tij do të angazhojë një grup të gjerë nga komunitet, përfshirë këtu përfaqësues nga çdo fshat, nga gratë, të rinjtë, të moshuarit, dhe grupe të tjerë vulnerabël të popullatës.

I realizueshëm. PZHL si një plan do të përmbajë hapa veprimi dhe projekte që janë të realizueshme. Ai do të ketë për qëllim të vendosë një balancë midis projekteve/veprimeve që mund të përfshihen në buxhetin e komunës ose të realizueshme nga komuniteti me pak përpjekje financiare dhe atyre që mund të kenë nevojë për financim të jashtëm (donatorë, grante, etj).

I koordinuar me prioritetet dhe objektivat rajonale dhe kombëtare, atëherë kur ka lidhje me to. Megjithatë pikënisja për zhvillimin e një PZHL dhe fokusi i tij është komuniteti, pushteti lokal duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë përputhjes së PZHL me planet në nivelet më të larta. Kjo vëmendje do të sigurojë që PZHL të mos përmbajë projekte/objektiva që bien ndesh me planet rajonale apo kombëtare, por në të kundërt, t'i zhvillojnë dhe mbështesin ato.

Një mjet që **demonstron përgjegjësi, besueshmëri dhe transparencë.** PZHL duke angazhuar komunitetin në procesin e zhvillimit, jo vetëm është i detyruar që t'i përgjigjet preferencave dhe nevojave të tij por është edhe një mjet për të vënë para përgjegjësisë qeverinë lokale në kryerjen e detyrës së saj.

Komponentët e Planit të Zhvillimit Lokal të FSHZH

Një vizion i përbashkët

Komunitet shqiptarë përballen me shumë sfida për zhvillim dhe burime të pakta për t'i përballuar ato – por gjithashtu ka shumë mundësira. Detyra është t'i bashkojmë të gjitha burimet dhe komunitetin në një vizion të përbashkët për të cilin mund të mobilizohen dhe të përdorin sa më mirë burimet njerëzore, natyrore dhe financiare. Për të arritur këtë, procesi për hartimin e PZHL fton këshilltarët dhe komunitetin për "të pikturuar" të ardhmen e tyre në 10-15 vitet e ardhshme. Ky aktivitet rezulton në "Vizioni i Komunitetit".

Një plan për të ardhmen

E ardhmja e çdo komuniteti sigurisht që ndryshon – dhe qeverisja vendore duhet të sigurohet, që ata, me zërin e komunitetit, janë autorë të këtij ndryshimi, duke iu kundërvënë situatave që përcaktojnë të ardhmen e tyre. PZHL përmban qëllime dhe hapa veprimi të realizueshme, të cilat mund të arrihen hap pas hapi në rrugën për të përmbushur Vizionin e Komunitetit.

Katër shtyllat e zhvillimit

Metodologjia e FSHZH përcakton një rrjet të gjerë në mënyrë që të sigurojë që të gjitha prioritetet e zhvillimit përfshihen në PZHL. Të gjitha qëllimet strategjike dhe projektet konkrete janë të organizuara në bazë të katër fushave të mëposhtme prioritare:

Zhvillimi Ekonomik: bizneset e vogla dhe të mesme, bujqësia, industria, tregu, turizmi, marketingu dhe shërbime të tjera.

Zhvillimi Social: shëndetësia, edukimi, të rinjtë, asistencë sociale, pensionet.

Infrastruktura Publike dhe Shërbimet: rrugët, furnizimi me ujë të pijshëm dhe kanalizimet, shërbimi i pastrimit, infrastruktura e arsimit dhe shëndetësisë.

Mirë-Qeverisje: përgjegjësia, përfshirja, informimi i publikut, besueshmëria, shërbimi ndaj 'klientit', menaxhimi efektiv i shërbimeve, zhvillimi organizativ me qëllim përmbushjen e qëllimeve strategjike.

Një komunitet, shumë zëra

Komunitet janë të përbërë nga shumë zëra: gra, burra, fëmijë, të rinj, të moshuar, biznesmenë, fermerë, mësues, të papunë, grupe etnike, invalidë, e kështu me rradhë. Është kritike për qeverisjen lokale që të kuptonim shpesh se sa të ngjashme po aq dhe të ndryshme ishin nevojat dhe pritshmëritë e këtyre grupeve. Proçesi i PZHL inkurajon të gjithë banorët e komunitetit të marrin pjesë në hartimin e këtij plani dhe në zbatimin e suksesshëm të tij. Metodologjia e hartimit me pjesëmarrjen e PZHL përfshin një sërë instrumentash me qëllim përmirësimin e komunikimit me publikun: Festivali i Vizionit të Komunitetit, pyetësorë, dhe mbledhje publike të tjera të hartuara në mënyrë që të japin komente rreth draftit të planit (duke përfshirë mbledhje publike rreth buxhetit).

Komunikimi me publikun

Plani i Zhvillimit Lokal është një bashkëbisedim me komunitetin. Hartohet nëpërmjet marrjes së mendimeve dhe udhëzimeve nga komuniteti. Për të qënë i qëndrueshëm, PZHL kërkon që ky bashkëbisedim të jëtë i vazhdueshëm. Në metodologjinë e FSHZH, qeverisja lokale inkurajohet që të nxisë dialogun dhe opinionin e vazhdueshëm në mënyrë që të sigurojë që puna që bëjnë ndikon ashtu siç duhet tek komuniteti

Një panoramë më e gjerë

PZHL ka të bëjë me të menduarin në terma afatgjatë në lidhje me nevojat e zhvillimit të një lokaliteti të caktuar. Sidoqoftë, proçesi i PZHL në metodologjinë e FSHZH merr

parasysh edhe Strategjinë Rajonale të Zhvillimit, në mënyrë që të sigurojë harmonizimin me Objektivat Rajonale dhe Kombëtare të Zhvillimit për Mijëvjeçarin (OZHM).

Kush u përfshi në hartimin e Planit të Zhvillimit Lokal?

Për të pasur një proces të hapur dhe transparent, në hartimin e planit për zhvillimin e komunës, është synuar një pjesmarrje e gjerë nëpërmjet krijimit të grupeve të këshillimit me bazë pjesmarrjen e komunitetit. Pjesmarrja e tyre është kyç për suksesin e hartimit dhe zbatimit të PZHL.

Grupi i Planit të Zhvillimit Lokal (grupi PZHL): Ky grup është përgjegjës për nxitjen, udhëheqjen, këshillimin dhe mbikqyrjen e hartimit të PZHL. Grupi i PZHL-së së përbëhet nga përfaqësues të këshillit, përfaqësues nga administrata e komunës, përfaqësues të fshatrave si dhe përfaqësues nga komuniteti me profesione të ndryshme. Ky grup është i ndarë në disa nëngrupe si më poshtë:

Grupi i Monitorim-Vlerësimit me Pjesmarrje (grupi MVP): Grupi i MVP-së ngarkohet të punojë në përcaktimin e kriterëve të vlerësimit të procesit të PZHL, të identifikojë treguesit për realizimin e objektivave strategjike dhe hapave të veprimit, si dhe vlerësimit të arritjeve të rezultateve. Me përfundimin e planit dhe aprovimit të tij në Këshill, grupi i MVP do të kryejë monitorim të vazhdueshëm të rezultateve të PZHL.

Nënkomitetet e Fushave Prioritare: Këto nënkomitete të grupit të PZHL përfaqësojnë katër shtyllat (*zhvillimi ekonomik, zhvillimi social, infrastruktura e shërbimet publike dhe qeverisja e mirë*) dhe janë përgjegjëse në përcaktimin e hapave të veprimit/projektet konkrete për fushat prioritare dhe hartimin e prefizibiliteteve dhe fizibiliteteve. Këto grupe mund të ftojnë dhe specialistë të tjerë të jashtëm që të japin ekspertizën e tyre në detajimin e hapave të veprimit/projekteve konkrete.


Nëngrupe të tjera të grupit të PZHL të hartuara për të siguruar një përdorim eficient të metodologjisë, janë: nëngrupi i mobilizimit të komunitetit, nëngrupi i mbledhjes së informacionit dhe sekretariati për mbledhjen dhe mbajtjen e informacionit voluminoz që do të krijohet gjatë hartimit të planit.

Si realizohet procesi?

Metodologjia e FSHZH përmban dhjetë hapa kyç në hartimin e planit të zhvillimit lokal.

1. **Garantimi i angazhimit lokal:** FSHZH takon Kryetarin e Komunës i cili përfiton aprovimin konceptual nga Këshilli i komunës për të ecur përpara në hartimin e planit të zhvillimit.
2. **Ofrimi i asistencës:** FSHZH ofron trajnim intensiv grupit të PZHL.
3. **Fillimi i punës:** Grupi i PZHL dhe nëngrupet e tij organizojnë takime dhe caktojnë planin e aktiviteteve që do të ndjekin.
4. **Mbledhja e informacionit:** Profili i Komunës, Pyetësorë dhe një sesion strategjik në Këshill përbëjnë aktivitetet kryesore të mbledhjes së të dhënave që do të furnizojnë me informacion hartimin e planit.
5. **Mobilizimi i komunitetit:** Panairët e ideve të fshatrave organizohen në çdo fshat dhe fokus, grupet hartohen për grupe të vecanta.
6. **Sintetizimi i të dhënave:** Grupi i LDP analizon inputin dhe përcakton vizionin dhe qëllimet strategjike.
7. **Krijimi i planeve të veprimit për fushat prioritare:** nënkomitetet e fushave prioritare identifikojnë dhe prioritojnë projektet/hapat e veprimit si edhe kryejnë studimet e pre-fizibilitetit; Grupi i PZHL përmbledh planin.
8. **Kthimi në fshatra:** Ju folët, ne ju dëgjuam, a u kuptuam drejt? Mundësi për të rishikuar draftin e PZHL me komunitetin dhe për t'u siguruar që ky plan përkon me ekspektacionet e tyre.
9. **Integrimi me procesin e buxhetit dhe aprovimi në Këshill:** PZHL informon rreth vendimeve të rëndësishme që kanë të bëjnë me alokimin e burimeve dhe aprovohet nga Këshilli.
10. **Zbatimi dhe monitorim-vlerësimi i vazhdueshëm:** Grupi i PZHL fillon zbatimin e planit dhe vazhdon të monitorojë dhe vlerësojë progresin e bërë për të arritur qëllimet.

Struktura e procesit të PZHL



Cili është afati kohor për Planin e Zhvillimit Lokal?

PZHL përmban plane veprimesh afatshkurtër, të mesme dhe afatgjatë. Vizioni përfshin një periudhë kohore prej 10-15 vjetësh dhe qëllimet strategjike deri në 5 vjet. Sidoqoftë, për të qenë sa më realistë dhe të sigurt që komuniteti do të jetë në gjendje të fokusohet në projektet konkrete, hapësira e veprimit është ngushtuar në 1-3 vjet dhe është synuar pikërisht në kohën e hartimit të buxhetit. Çdo hap veprimi ka një afat kohor për zbatim. Përputhja me këto afate kohore do të monitorohet nga grupi i monitorim-vlerësimit me pjesmarrje.

SHOQËRIA (KAPITALI SOCIAL)

a. Komuniteti dhe dinamika

Komuna Qendër ka në juridiksionin e saj 10 fshatra:

Mujalli, Grecalli, Daullas, Afrim i Ri, Çlirim, Radostinë-Vadhizë, Zhupan, Drizë, Drizë Myrteza dhe fshati Rom.

Jashtë juridiksionit të kësaj komune, por me prona të regjistruara këtu, kanë mbetur fshatrat Afrim (Qenas), Mbrostar, Çeligrad, Bishanakë, Fier Çifçi, Sheq i Madh dhe Sheq i Vogël të cilët para vitit 1992 bënë pjesë në ish-këshillin e bashkuar dhe sot ato i janë bashkuar Bashkisë Fier.

TABELA 1: SHPËRNDARJA E POPULLSISË

Nr.	Fshati	Nr. i banorëve			Nr. i familjeve në vitet	
		Femra	Meshkuj	Gjithsej	2005	2008
1.	Mujalli	326	357	683	167	171
2.	Grecalli	401	405	806	235	227
3.	Daullas	538	606	1,144	291	305
4.	Afrim i Ri	217	213	430	110	112
5.	Çlirim	1,326	1,358	2,684	732	745
6.	Radostinë/Vadhizë	393	451	844	203	208
7.	Zhupan	1,057	1,111	2,168	522	537
8.	Drizë 1	365	439	804	201	211
9.	Drizë 2	258	272	530	126	133
10.	Rom	895	842	1,737	307	329
KOMUNA (Total)		5,776	6,054	11,830	2,894	2,978

Komuniteti që banon në komunën Qendër, është i larmishëm. Ai përbëhet nga banorët autoktonë myzeqarë si dhe nga popullsi arumene, çame, kosovare, rome e malësore të veriut ardhur në vitet 1991-2000.

Popullsia Çame është vendosur në vitet 1935-1945, Kosovarët janë ardhës të viteve 1925-1930 ndërsa Romët janë grumbulluar në vitet 1958-1960.

Rregjistrimet e para në këtë njësi datohen zyrtarisht në vitin 1923 sipas të cilit, fshatrat e kësaj komune banoreshin nga 179 familje me 1084 banorë. Popullsia e kësaj Komune ka pësuar ndryshime në rritje nga njëri 10-vjeçar në tjetrin.

Ndryshimet kryesore shoqërore, sociale, ekonomike e politike të diktaturës 1945-1990 janë: Reforma Agrare e vitit 1946, ku të gjitha familjet fshatare përfituan tokë që e patën

pronën e tyre me tapi deri në organizmin e kooperativave bujqësore. Në vitin 1958, përfundoi kolektivizimi i bujqësisë në këtë zonë, organizimi shoqëror pësoi ndryshime si në planin ekonomik ashtu edhe në qeverisjen vendore. Në këtë periudhë nisi të funksionojë Këshilli i Bashkuar. Në vitin 1972, në zonën që përfshin Komuna Qendër sot, u krijua Kooperativa e Tipit të lartë. Edhe në këtë rast, funksionet e pushtetit vendor i kryente Këshilli Popullor i Bashkuar me kryetarin në krye. Në vitin 1983 ish-kooperativa bujqësore Grecalli u kthye në Ndërmarrje Shtetërore duke e zhdukur tërësisht nocionin e pronës shoqërore.

Pas viteve 1990, ndryshimet e mëdha shoqëruan edhe komunën Qendër. Eksodi dhe tendenca e hapjes së vendit drejt Europës, u shoqërua edhe me lëvizjen e lirë të njerëzve. Shumë familje nga fshatra të ndryshme të Komunës Qendër, u vendosën në qytete ose në qendra të reja banimi dhe shumë të tjera erdhën e u vendosën në këtë zonë shpesh pa kriter duke shkaktuar edhe probleme sociale. Emigracioni i njerëzve pas eksodeve të mëdha mori përmasa të gjera për shumë të rinj dhe familje të ndryshme që u larguan në drejtim të Greqisë, Italisë etj. Aplikimi dhe sistemi i Llotarisë Amerikane, përfshin shumë banorë e familje të Komunës sonë. Sipas statistikave jozyrtare, mendohet se në këtë periudhë gati 5000 persona provuan kalimin e kufijve duke patur qëndrime të shkurtra ose disaveçare sidomos në Itali e Greqi.

Sot, Komuna Qendër ka një dendësi mesatare prej 465 banorë/km², me një rritje natyrore 3,8% ose 19 lindje për 1000 banorë.

b. Arsimimi

Popullsia e komunës Qendër është arsimdashëse dhe aspiron për një jetë me vlera të mirëfillta qytetare. Tregues për këtë është historiku i pasur 50-vjeçar i zhvillimit të arsimit e kulturës ku nga ky komunitet kanë dalë e shërbejnë dhjetëra e dhjetëra mësues, pedagogë, agronomë, mjekë, inxhinierë, arkitektë, gjeologë, ekonomistë, oficerë e shumë profesione të tjera.

Aktualisht në juridiksionin e komunës Qendër ka tri shkolla 9-vjeçare, tri shkolla fillore, një shkollë të mesme dhe 8 kopshte fëmijësh.

Në fshatin Çlirim funksionon shkolla e mesme "Rakip Kryeziu", një shkollë kjo me tradita të shkëlqyera për faktin se është ndër më të vjetrat e vendit që u hap në vitin 1952 me profil bujqësor. Në vite nga kjo shkollë kanë dalë: 2453 agronomë, 1082 zooteknikë, 598 zooveterinerë, 15 veterinerë, 25 specialistë frutikulture.


Ish-nxënësit e kësaj shkolle kanë dhënë kontributin e tyre në çdo cep të Shqipërisë, për zhvillimin dhe modernizimin e bujqësisë si në fushën studimore-shkencore ashtu edhe në veprimtari praktike e drejtuesi deri në drejtues dikasteresh e ministra.

Në vitin 1992-1993 kjo shkollë kaloi nën juridiksionin e Komunës Qendër dhe në vitin shkollor 2001-2002, kësaj shkolle iu bashkua shkolla profesionale me degët: Agrobiznes, Hidraulik, Mobileri, Ushqimore, Konfeksione.

Aty sot studiojnë mesatarisht 470 nxënës me 58 mësues, ku përveç këtyre rreth 460 nxënës studiojnë me korrespondencë shkollën e mesme të përgjithshme. Duhet theksuar

se kjo është shkollë rajonale për rrethet e Jugut dhe është me konvikt. Në trazirat e viteve '96-'97-'98 ndodhën shkatërrime të institucioneve arsimore. Ndryshimet nisën gradualisht, si në drejtim të reabilitimit të infrastrukturës ashtu edhe në mirëmbajtje. Përmirësimet më të dukshme janë bërë në mjediset e brendshme e të jashtme të shkollave si dhe në terrenet sportive.

Fig. 1 - Kënaqshmëria për gjendjen e shkollave




Kjo u arrit nga rritja e investimeve, prej të cilave më kryesoret janë:

- Rikonstruksioni i shkollës 8-vjeçare Zhupan
- Ndërtimi i murit rrethues të kopshtit Drizë Myrteza
- Rikonstruksioni i shkollës fillore Mujalli dhe rrethimi i saj
- Ndërtimi i murit rrethues të kopshtit Daullas
- Rikonstruksioni i palestrës dhe ndërtimi i ambienteve sportive në shkollën e mesme "Rakip Kryeziu", që janë në proces.

c. Kultura dhe koha e lirë


Në këtë nocion përfshihen grupet artistike e ato të estradës, këngët e vallet, e aktivitete të tjera. Komuna Qendër, ka pasur para viteve '90 një jetë të pasur kulturore dha artistike.

Fig. 2 - Kënaqshmeria për programet artistike & kulturore



Në çdo fshat funksiononin vatrat e kulturës në godina të thjeshta, kurse në fshatrat Mujalli, Grecalli, e Mbrostar u ndërtuan godina të reja me mjedise të posaçme për shfaqje, me biblioteka të pasura dhe të frekuentueshme. Shtëpitë e Kulturës të qendrës Grecalli e Çlirim kanë qenë të përfaqësuar në veprimtari kombëtare si në Festivalin Folklorik Kombëtar të viteve 1973, 1978, 1983, 1988 ku me drejtues të përkushtuar dhe artistë të zonës, kanë zënë vende nderi dhe kanë mbushur programet televizive të asaj kohe. Në Grecalli e në Çlirim ka patur salla kinemaje që frekuentoheshin nga banorët rregullisht. Në këtë drejtim ka një traditë që duhet ringjallur nga brezat sot e në të ardhmen.

Fig. 3 - Kënaqshmëria për aktivitetet sportive



Ndër aspektet që vlen të përmenden këtu, është dhe kujdesi i veçantë që i kushton kjo komunë zhvillimit të sporteve, për të cilën, në mënyrën si po e trajtojmë këtu, kjo është një përvojë e re. Brenda territorit të komunës funksionojnë tre terrene sportive, prej të cilëve ai pranë shkollës "Rakip Kryeziu", është një kompleks sportiv me fushë futbollit, fushë basketbollit, volejbollit, pista vrapimi. Është ndërtuar edhe tribuna dhe mjedise të tjera të thurura, që mirëmbahen nga punonjës me pagesë.

Në komunë ka tashmë një ekip modest futbollit që debutoi në kategorinë e dytë, ku në sezonin e vitit 2003-2004 u klasifikua në vendin e dytë duke u dhuruar sportdashësve të shumtë çaste të bukura shplohëse e dëfrimi. Mbarëvajtja e këtij ekipi trajtohet nga komuna në të njëjtin plan si me problemet e tjera të saj.

Është bërë traditë e bukur zhvillimi i shumë veprimtarive masive sportive, ku përveç spartakiadave, çdo vit këtu organizohet "Dita Olimpikë", me pjesëmarrje masive shumëgarëshe të shkollave të komunës.


Çdo veprimtari fiskulturore-sportive që organizohet në komunë, i paraprihet me programe të veçanta, në bashkëpunim komunë-drejtori shkollash-mësues e drejtues në administratën e komunës.

d. Shërbimi shëndetësor

Shërbimi shëndetësor në fshatrat e komunës Qendër, ka nisur rreth viteve 1950, ku shërbehej me infermierë, kurse vizitat mjekësore bëheshin në qytetin e Fierit. Shërbimi me infermier në fshatin Drizë, i ka fillimet në vitet 1948-1949, në Zhupan 1950-1951, në Çlirim 1951, në Grecalli 1952, në Vadhizë 1953.

Në vitin 1957 në fshatin Çlirim u emërua një ndihmësmjek, Dhori Suku. Fshatrat Mujalli, Grecalli e Daullas, shërbimin mjekësor e siguronin në Fier deri në vitin 1974. Në fshatin Zhupan, shërbimi me mjek ka filluar në vitet 1964-1965.

Fig. 4 - Kënaqshmëria për qendrat shëndetësore



Komuna dhe Këshilli i saj, vazhdimisht kanë ndjekur me përparësi mirëmbajtjen e qendrave shëndetësore dhe bëjnë kujdes për ruajtjen e higjienës e pastërtisë në fshatra duke e vlerësuar shërbimin mjekësor si detyrë parësore.

Në komunën Qendër, sot funksionojnë 4 qendra shëndetësore, me 4 mjekë dhe 10 infermierë e mami.

e. Asistenca sociale


Në komunën Qendër trajtohen me ndihmë ekonomike 182 familje. Numrin më të madh të familjeve të trajtuara, e përbëjnë ato të komunitetit rom, pasi niveli i tyre ekonomik është nën minimumin jetik.

Emërtimi i fshatit Rom është marrë nga vetë emri i fiseve rome që banojnë aty, të cilët janë përqëndruar në familje rreth viteve 1956-1958 e që kanë ardhur duke u shtuar nga viti në vit me familje të reja. Disa prej banorëve kanë ndërtuar shtëpi dhe jetojnë në kushte të mira. Kjo popullsi më parë merrej me tregtinë e kuajve, me zeje e me thurje kanistrash.

Gjatë viteve të demokracisë romët qenë ndër të parët që tregtuan rroba të përdorura dhe sende të ndryshme shtëpiake që i sillnin nga Greqia. Tregu rom lulëzoi disa vite dhe ndikoi shumë në rritjen e nivelit të tyre të jetesës, por me rritjen ekonomike klientët dhe

blerësit e tyre u zvogëluan.


Fig. 5 - Numri i familjeve me ndihmë ekonomike sipas fshatrave



f. Cilësia e jetës


Banorët e komunës Qendër, kanë kërkesa të larta për jetën. Në përgjithësi ata kanë shtëpi të mira, të reja e të rikonstruara, të pajisura me televizorë, lavatriçe, frigoriferë etj. Shumica e familjeve kanë në pronësinë e tyre makina private. Komuna numëron rreth 310 makina private për përdorim familjar. Niveli mesatar i të ardhurave në komunë është 28 mijë lekë / frymë.

Fig. 6 - Cilësia e jetës



Komuna ofron shërbimet kryesore publike si atë të pastrimit, gjelbërimit, mirëmbajtjes së rrugëve, shkollave, kopshteve etj.

Fig. 7 - Përmirësimi i cilësisë së jetës tre vitet e fundit




EKONOMIA

a. Situata e përgjithshme

Klima e butë mesdhetare bregdetare, karakteristike për zonën e Myzeqesë, me reshje mesatare e shumë diell, krijon mundësi që në këtë komunë të zhvillohet një bujqësi intensive e përparuar, ndërsa pozicioni në qendër ndikon në zhvillimin e bizneseve të ndryshme fitimprurëse.

Pronat e popullsisë fshatare të Komunës janë kryesisht pranë vendbanimit të tyre me ndonjë përjashtim të vogël ku disa familje kanë ngastra toke jashtë fshatit të tyre. Banorët e fshatrave Afrim, Mbrostar, Çeligrad, Bishanakë, Sheq i Madh, Sheq i Vogël, detyrimet dhe taksat për tokën, i kanë të lidhura me Komunën Qendër, pavarësisht se përfshihen në Bashkinë e Fierit.

Fig. 8 - Kënaqshmëria për mundësitë për të ndërmarrë një biznes



13	Aktivite të organizmave ndërkombetare	0	0	0	0	0	0	0	0	0
KOMUNA TOTAL		2570	5204	2468	16	173	102	2562	5444	2566

b. Blegtoria

Shumica e familjeve fermere në këtë komunë rrisin dhen, dhi, lopë, derra, e shpendë si pula fushe, pata, rosa, gjela deti etj. ku një pjesë e produktit përdoret për nevoja vetiake dhe pjesa tjetër për treg sidomos perimet e bostanët që kultivohen në sera diellore. Fermerëve që merren me blegtori u vjen në ndihmë të vazhdueshme edhe Zyra e Shërbimit Veterinar në komunë e mbështetur në Ligjin nr. 7674 - "Për shërbimin dhe inspektoriatin veterinar".

TABELA 3: BLEGTORIA

Nr.	Fshati	Të imta		Gjedhë	Shpendë
		Dele	Dhi		
1	Mujalli	750	7	390	2500
2	Grecalli	650	5	300	3000
3	Daullas	350	0	430	2400
4	Afrim i Ri	400	0	80	880
5	Radostinë Vadhizë	1000	85	180	1210
6	Çlirim	70	0	220	2450
7	Drizë 1	350	0	160	2000
8	Drizë 2	70	0	130	2650
9	Zhupan	300	0	180	2600
10	Rom	10	0	0	100
KOMUNA		3950	97	2070	19790

Objekt pune i kësaj zyre është edhe kontrolli i pikave të therjes, kontrolli i aktivitetit të veterinerëve praktikë, periodikisht përgatitet Buletini veterinar, kontrolli i subjekteve që tregojnë produkte blegtorale etj.

Për të gjitha veprimtaritë e zyrave në komunë, Këshilli i Komunës dhe kryetari i saj ndjek me përparësi realizimin cilësor të shërbimeve në tërësi dhe për këtë ka një dokumentacion të arkivuar.

Komuna ka sot mbi 6,500 krerë bagëti dhe mbi 10,000 shpendë. Mbarështuesit e blegtorisë sigurojnë rreth 23 mijë lekë të ardhura/ha nga aktiviteti i tyre.

TABELA 4: PRODHIMI BLEGTORAL

Nr.	Fshati	Delet			Dhitë		Lopët		Shpendët	
		Mish (kv)	Qumësht (litra)	Lesh (kv)	Mish (kv)	Qumësht (litra)	Mish (kv)	Qumësht (litra)	Mish (kv)	Vezë (kokrra)
1.	Mujalli	17	45.5	1.5	0.385	0.021	56	892	4.5	180
2.	Grecalli	6	13	0.9	0	0.015	60	720.5	9.9	200
3.	Daullas	5	9	0.7	0	0	60	926.1	5.4	160
4.	Afrim i Ri	4.5	10.8	0.8	0	0	15	167.5	1.6	50
5.	Radostinë Vadhizë	21.8	48	2	1.3	7	30	445.9	3.6	60
6.	Çlirim	0.6	0	0.14	0	0	31	514.5	3.6	150
7.	Drizë 1	4	9	7	0	0	21	323	6	100
8.	Drizë 2	1	1.8	0.14	0	0	21	257.7	5	150
9.	Zhupan	4	9	0.6	0	0	30	399.6	6.5	150
10.	Rom	0.025	0	0	0	0	0	0	0.01	0.001
KOMUNA		63.925	146.1	13.78	7.036	7.036	324	4646.8	46.11	1200

c. Bujqësia


Në përgjithësi bujqit dhe fermerët kultivojnë në pronat e tyre shumëllojshmëri bimësh të arave si: misër, grurë, elb, tërshërë, thekër, luledielli. Gjithashtu kultivohen perime të ndryshme si: fasule, patate, bostan, qepë, hudhra, lakra, spinaq, domate, specia, bamje, patëllxhanë etj. Zona është e pasur me dru frutorë si: ullinj, agrume, kumbulla, fiq, ftonj, dardha, pjeshkë, shegë, vreshta dhe bimë zbukurimi sidomos në zonën kodrinore.

Në komunën Qendër zhvillojnë aktivitetin e tyre 5576 ferma private, me një sipërfaqe rreth 0,6 ha secila. Pronarët e fermave sigurojnë rreth 42 mijë Lek të ardhura/ha nga kultivimi i drithërave, rreth 16 mijë Lek/ha nga pemëtaria dhe rreth 12 mijë Lek/ha nga perimet.

TABELA 5: PRODHIMI NGA DRITHËRAT

Nr.	Fshati	Drithëra			Produkte bujqësore			Frutikulturë	
		Grurë (t)	Misër (t)	Thekër (t)	Të ndryshme (t)	Patate (t)	Fasule (t)	Fruta (t)	Vreshtë (t)
1.	Mujalli	400	177	-	1361	45	18	57	20
2.	Grecalli	400	152	-	550	24	3	30	1
3.	Daullas	270	57	-	500	14	4	36	0
4.	Afrim i Ri	106	0	-	66	0	1	20	10
5.	Çlirim	330	120	-	274	65	5	17	40
6.	Radostinë Vadhizë	220	30	-	300	54	1	61	20
7.	Zhupan	227	31	-	8	51	1	61	20
8.	Drizë 1	204	31	-	300	80	1	21	20
9.	Drizë 2	172	31	-	200	16	1	22	30
10.	Të tjerë	1127	261	-	14918	275	22	343	122
KOMUNA		3456	890	0	18477	624	57	678	283

Fig. 9 - Prodhimi në Ton sipas kulturave në Komunën Qendër



d. Telekomunikacioni dhe Teknologjia Informuese

Të gjithë fshatrat e komunës kanë lidhje telefonike fikse. Kjo mundësohet nga Albtelecom dhe nga operatorët privatë ruralë. Shumë i përhapur është përdorimi i telefonisë celulare. Për të dëshiruar është shërbimi i internetit. Asnjë nga fshatrat e komunës nuk ka një shërbim të tillë. Mundësinë për të përdorur internetin banorët e komunës e gjejnë në qytetin e Fierit.

MJEDISI DHE INFRASTRUKTURA

a. Pozita gjeografike e komunës

Si njësi administrative vendore Komuna Qendër ushtron sovranitetin e saj në territorin ku më parë përfshiheshin ish-ndërmarrjet bujqësore “Çlirim” dhe “Grecalli” me përjashtime të disa zonave. Quhet Komuna Qendër për pozicionin gjeografik të vendosjes së saj rreth qytetit të Fierit. Kjo Komunë kufizohet në Veri me komunën e Libofshës, nga e cila e ndan lumi Seman, pak më në Veri-Lindje kufizohet me komunën e Mbrostarit, në Lindje me komunën Zharrëz, në Perëndim e Jug-Perëndim kufizohet respektivisht me komunën e Topojës (Seman) e të Dërmenasit e në juglindje me komunat Levan e Portëz.

Komuna Qendër ka relief fushor, por nuk i mungojnë kodrat, të cilat zgjaten në të dy krahët e Qafës së Koshovicës për të vazhduar në perëndim me kodrat e fshatrave Zhupan, Radostinë, Vadhizë, e deri në kuotën më të lartë 169 m ku dhe kufizohet me kodrat e Apolonisë së lashtë.

Kësaj zone me 85% fushë, kodrat e veshura dhe ndërtimet e reja tip vile si dhe lokalet e bukura të ndërtuara vitet e fundit në mes të gjelbërimit, i japin zonës një pamje piktoreske dhe i bëjnë ato të vizitueshme nga banorët përreth.

b. Burimet natyrore

TABELA 6: BURIMET NATYRORE

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	% në shfrytëzim
1.	Vijë bregdetare	Km	0	-
2.	Lumenj	Km	1	-
3.	Liqene	-	0	-
4.	Rezervuare	Copë	3	-
5.	Laguna	-	0	-
6.	Tokë bujqësore	Ha	3558	95
7.	Pyje	Ha	45	100
8.	Kullota	Ha	30	-
9.	Troje të tjera	Ha	115	-
10.	Parqe hapësira të gjelbërta	-	-	-
11.	Burime Minerale	-	-	-
12.	Lëndë e parë për materiale ndërtimi	-	-	-
13.	Specie të mbrojtura	-	-	-
14.	Zona të mbrojtura	-	-	-
15.	Monumente oken e të mbrojtura	-	-	-
16.	Të tjera	-	-	-

Të gjitha tokat e komunës Qendër përshkohen nga kanali Vjosë – Levan – Fier.

Në territorin e komunës janë ndërtuar tre ujëmbledhës përkatësisht 2 janë në fshatin Radostinë Vadhizë dhe 1 në fshatin Drizë Myrteza.

Toka në komunë është oken e banorëve të saj dhe si e tillë ajo mbrohet me ligj.

Ish-Zyra e Kadastrës është shndërruar në Zyrë të Menaxhimit e të Mbrojtjes së tokës bazuar në Ligjin nr. 8752, dt. 26.03.2001.

Gjatë veprimtarisë së kësaj zyre është realizuar tërheqja e dokumenteve të tokës për të gjitha fshatrat dhe është bërë sistemimi i tyre.

Mbështetur në dokumentet përkatëse, janë zgjidhur shumë konflikte pronësie të mbartura oken fshatrat Mujalli, Daullas, Drizë, Zhupan, Afrim e Mbyet, konfliktet e 42 familjeve në Çlirim, ai midis pronarëve të tokave në Drizë, Zhupan e Fier-Çifçi, konfliktet për hapje rrugësh në parcela, kërkesat e qytetarëve për rregullime të gabimeve të bëra

nga komisionet e ndarjes së tokave të fshatrave si dhe kërkesat e ankesat e natyrave të ndryshme. Në vijim të punës së nisur ka filluar kompjuterizimi i dokumentave për oken dhe shërbime të tjera.

Fig. 10 - Kënaqshmëria për ruajtjen e ambientit natyror




Tabela 7 tregon sipërfaqet e tokës bujqësore që përfitojnë dhe jo nga sistemet vaditëse dhe kulluese.

TABELA 7: SISTEMI UJITËS

Nr.	Fshati	Ha mbi Ujë	Ha nën ujë	Rrjeti Kryesor (km)	Rrjeti sekondar (km)	Rrjeti tercor (km)	Përfitues (familje)
1.	Mujalli	-	255	2	3.9	10.5	144
2.	Grecalli	-	275	2	4.4	12	240
3.	Daullas	-	292	4	3.5	13.5	230
4.	Afrim i Ri	-	32	1	2	8	78
5.	Çlirim	135	265	3	4.3	24	670
6.	Radostinë Vadhizë	145	80	3	3	9	190
7.	Zhupan	230	170	2	3	12	448
8.	Drizë 1	78	100	2	2	10	161
9.	Drizë 2	48	52	1	2	9	98
10.	Të tjerë	0	1411	9.3	21.8	58.5	3190
KOMUNA		636	2932	29.3	49.9	166.5	5449

c. Sistemi rrugor

Fshatrat Daullas, Grecalli dhe Mujalli shtrihen në veri të qytetit të Fierit dhe lidhen me rrugë rurale të shtruara me kalldrëm, me gjatësi 9 km. Fshatrat Afrim i Ri e Çlirim ndodhen në Perëndim të qytetit të Fierit në të dy anët e rrugës së asfaltuar Fier-Seman në distancë që arrin 3 km.

Fshatrat Drizë e Drizë Myrteza janë të vendosur në Jug-Lindje të qytetit të Fierit në të majtë të rrugës Fier-Vlorë kurse në krahun e djathtë shtrihet fshati Zhupan dhe në vazhdim të tij drejt Perëndimit, rrëzë kodrave janë fshatrat Radostinë-Vadhizë.


Fshati Rom është i vendosur përpara ish-kompleksit industrial Azotik në anë të hekurudhës Fier-Ballsh, në bregun e majtë të lumit Gjanicë. Të gjithë fshatrat e Komunës përshkohen nga rrugë të brendshme komunikuese, ndërtuar sipas planimetrisë tradicionale urbane, kryesisht të shtruara me kalldrëm dhe disa segmente me asfalt.

TABELA 8: GJENDJA E RRUGËVE

Nr.	Fshati	Rruge rurale komunale (km)		Rruge Lagje (km)		Sheshe (m ²)	
		Asfaltuar	Paasfaltuar	Asfaltuar	Paasfaltuar	Asfaltuar	Paasfaltuar
1	Mujalli	-	1.2	-	1.6	-	-
2	Grecalli	-	1.2	-	2	-	-
3	Daullas	0.22	1	-	2	-	-
4	Afrim i Ri	-	0	-	0.8	-	-
5	Çlirim	-	0.3	-	2.6	800	-
6	Radostinë Vadhizë	-	2.4	-	1	-	-
7	Zhupan	-	0.6	-	2.8	-	-
8	Drizë 1-	0.4	-	-	3	-	-
9	Drizë 2	-	1.2	-	1.3	-	-
10	Rom	-	1.2	-	1.1	-	-
KOMUNA		0.22	9.5	-	18.2	800	-

Fshatrat e komunës i sigurojnë lidhjet rrugore nëpërmjet një rrjeti rural prej 27,5 km dhe 6 km rrugë nacionale nga të cilat 3 km janë në aksin Perëndimor në drejtim të bregdetit dhe 3 km në aksin Jugor në drejtim të Vlorës. Brenda qendrave urbane janë 18 km rrugë dhe 9,5 km rrugë janë jashtë qendrave urbane. Komuna siguron mirëmbajtjen e rrjetit rural dhe atij të brendshëm.

Fig. 11 - Kënaqshmëria për rrugët



d. Furnizimi me energji elektrike

Të gjitha fshatrat e komunës furnizohen me energji elektrike të tensionit të lartë, me transformatorë të vendosur në shtylla dhe në kabina elektrike.


TABELA 9: FURNIZIMI ME ENERGIJE ELEKTRIKE

Nr.	Fshati	Rrjeti Kryesor TL (km)	Rrjeti kabllor i TU (km)	Numri i Kabinave Elektrike	Numri i Transformatoreve	Bokse kolektive (mates)	Mates Individuale	Perfitues (familje)
1.	Mujalli	4.81	-	2	2	8	150	158
2.	Grecalli	4	-	6	6	0	210	210
3.	Daullas	4	-	3	3	0	290	290
4.	Afrim i Ri	2.36	-	3	3	0	105	105
5.	Çlirim	5.6	-	8	8	100	480	580
6.	Radostinë Vadhizë	5	-	4	4	0	196	196
7.	Zhupan	3	-	7	7	16	474	490
8.	Drizë 1	3	-	6	6	0	207	207
9.	Drizë 2	3.3	-	2	2	0	116	116
10.	Rom	2.27	-	1	1	0	280	280
KOMUNA		37.34	-	42	42	124	2508	2632

e. Furnizimi me ujë të pijshëm

Fshatrat e komunës furnizohen me ujë të pijshëm nga rrjeti i furnizimit të qytetit të Fierit si edhe nga 4 stacione furnizimi. Nga rrjetit i qytetit furnizohen fshatrat Afrim i Ri, Zhupan,

Drizë 1, Drizë 2 dhe blloku 1 i fshatit Çlirim.



Fshatrat e tjerë furnizohen nga stacionet e pompave. Ata kanë një furnizim me orar të reduktuar për shkak të kapacitetit të ulët të furnizimit dhe mungesës së energjisë elektrike. Komuna siguron mirëmbajtjen e stacioneve të pompave si dhe të sistemit kryesor të shpërndarjes, sistemit të brendshëm të shpërndarjes në fshatra.


TABELA 10: FURNIZIMI ME UJË TË PIJSHËM

Nr.	Fshati	Rrjet Sistemi me ngritje mekanike	Rrjet sistemi me rrjedhje të lirë	Numri i Sistemeve të ujësjellësave	Numri i Sistemeve të pompimit
1.	Mujalli	1	-	1	1
2.	Grecalli	1	-	1	1
3.	Daullas	1	-	1	1
4.	Afrim i Ri	Furnizohet nga qyteti i Fierit			
5.	Çlirim	1	-	1	1
6.	Radostinë Vadhizë	1	1	2	1
7.	Zhupan	Furnizohet nga qyteti i Fierit			
8.	Drizë 1	Furnizohet nga qyteti i Fierit			
9.	Drizë 2	Furnizohet nga qyteti i Fierit			
10.	Rom	Furnizohet nga qyteti i Fierit			
KOMUNA		5	1	6	5

f. Kanalizimi i ujërave të zeza dhe të bardha

Komuna ka treguar vëmendje shumë të madhe për kompletimin e fshatrave me sistemin e KUZ-ve.

Fig. 13 - Kënaqshmëria për KUZ



Është ndërtuar rreth 90% e e KUZ-ve për fshatrat Mujalli, Grecalli, Daullas. Është në proces ndërtimi i KUZ-ve për fshatrat Zhupan, Drizë 1 dhe Drizë 2. Me kompletimin e rrjeteve komuna kujdeset për mirëmbajtjen e tyre.

QEVERISJA E KOMUNËS

a. Organika e komunës


Komuna drejtohet nga kryetari i komunës i cili zgjidhet një herë në katër vjet, me votim të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë. Kryetari i komunës është udhëheqës dhe menaxher. Ai bën të mundur bashkimin e segmenteve të kundërt në një forcë pozitive për të arritur vizionin e komunës. Ai punon për të sjellë përmirësime sasiore dhe cilësore në shërbime ashtu siç kërkohen nga banorët.

Organ tjetër i komunës është këshilli i komunës i cili është organ vendimarrës, politikbërës dhe mbikqyrës. Anëtarët e këshillit zgjidhen një herë në katër vjet, në të njëjtën kohë me kryetarin e komunës, mbi bazën e listave që vendosin partitë politike sipas sistemit propocional. Numri i anëtarëve në këshillin komunal varet nga numri i popullsisë së komunës. Komuna Qendër ka 18 anëtarë të këshillit komunal, nga të cilët vetëm 1 është grua

Komuna ka administratën e cila emërohet dhe drejtohet nga kryetari i komunës. Ajo punon për të përmbushur planet e kërkuara sipas standarteve të përcaktuara nga kryetari dhe këshilli i komunës.

Komuna Qendër ka një administratë të përbërë nga 30 anëtarë, nga të cilët 15 ose 50% janë me arsim të lartë dhe 10 ose 30% janë gra. Më poshtë është organograma e komunës.

Organograma e komunës Qendër



b. Buxheti i komunës

Në kushtet e ekonomisë së tregut, në një shoqëri që e ndërton jetën dhe nivelin e saj mbi bazën e iniciativës së lirë, lipset që secili të njohë e të zbatojë legjislacionin që ndërton marrëdhëniet e tij me shtetin. Në këtë aspekt, Këshilli i Komunës, Kryetari i Komunës, Zyrat e shërbimeve në komunë dhe administrata e saj i kushtojnë rëndësi të veçantë çdo subjekti për të qenë korrekt në marrëdhënie me detyrimet që ata kanë ndaj shtetit. Praktika e punës në Komunën Qendër dhe përvoja e fituar, ka bërë që për të administruar atë çfarë punohet, prodhohet dhe konsumohet duhet të vlerësohet dhe të menaxhohet në mënyrë reciproke duke mos toleruar dhe as tejkuluar liritë, të drejtat dhe detyrat e gjithsecilit. Zyra e Financës në Komunë ka bërë vazhdimisht përmirësime në njohjen, vlerësimin, krijimin dhe përdorimin e burimeve financiare duke rritur aftësinë e saj për planifikimin dhe drejtimin e tyre në zgjidhjen e kërkesave të qytetarëve. Financa në këtë Komunë është kthyer në përbërësin kryesor të mekanizmit të qeverisjes.

Deri në vitin 2000 në komunë nuk rezulton i regjistruar asnjë subjekt privat dhe shuma prej 670 mijë lekësh të grumbulluara nga taksat është pa origjinë. Në vitin 2001, duke zbatuar Ligjin Nr. 8435, Dt. 28.12.1998 "Për zbatimin e taksave në Republikën e Shqipërisë" filloi puna sistematike për regjistrimin e subjekteve private, të cilat u bënë me dosje të veçanta dhe u miratuan me vendim të Këshillit të Komunës. Në këtë periudhë u vendos që të krijohet Zyra e Tatim-Taksave që u kompletua me inspektorët përkatës të kualifikuar e të përkushtuar, e cila nisi punën sistematike që nga dokumentacioni për regjistrim-liçencimin e subjekteve deri në veprimtarinë e përditshme.

Gjatë viteve 2000-2006, ritmet e të ardhurave janë rritur në mënyrë progresive dhe kanë ndihmuar në realizimin e investimeve të bëra në këtë komunë veçanërisht në infrastrukturën e rrjetit rrugor, ndërtimin e kanaleve të ujërave të zeza, rikonstruksionin e rrjetit të ujit të pijshëm, në përmirësimin e rrjetit elektrik dhe në të gjitha shërbimet e tjera në dobi të komunitetit.

Fig. 14 - Të ardhurat e veta në komunën Qendër




Fig. 15 - Investimet në vite, Komuna Qendër





TABELA 11: TABELA E SHPENZIMEVE DHE TË DALAVE

Nr.	Funkcionet	Shpenzimet dhe të dalat					
		Totali	Pagat	Kontributi i Sigurimeve Shoqërore	Shpenzime operative & mirembajtje	Investime	Transferime
1.	Administrata e përgjithshme	21,372	10250	2,966	7,456	700	-
2.	Shërbime publike	26,750	2889	990	7,054	15,817	-
3.	Arsimi	40,991	31227	6,500	3,264	0	-
4.	Shëndetësia	1,551	0	0	0	1,551	-
5.	Kultura	0	0	0	0	0	-
6.	Çështje sociale	24,385	0	0	24,385	0	-
7.	Të tjera	2,356	0	0	2,356	0	-
8.	Fondi rezervë	0	0	0	0	0	-
KOMUNA TOTAL		117,405	44,366	10,456	44,515	18,068	-



c. Pjesmarrja qytetare

Komuna Qendër punon që t’i mbajë banorët të mirëinformuar rreth aktiviteteve dhe vendimeve si edhe t’i përfshijë ata në çështjet publike. Ajo përpiqet për të rritur cilësinë e shërbimeve duke krijuar mundësi për qytetarët që të marrin pjesë në mënyrë aktive në çështjet vendore si dhe të përfitojnë nga këto mundësi.

Komuna publikon buletin informativ një herë në tre muaj. Në këtë buletin publikohen planet e investimeve, vendimet e Këshillit të Komunës, informacion për bujqësinë dhe blegtorinë si dhe raporte për angazhimet dhe detyrat e realizuara.




Fig. 17 - Vlerësimi në besimin për aftësinë për të kthyer përgjigje & zhgjidhur problemin





Fig. 18 - Vlerësimi për ndershmërinë dhe drejtësinë



Në pyetësonin e realizuar me banorët e komunës 76% e banorëve shprehen se janë shumë mirë të informuar dhe mirë të informuar nga komuna.

Komuna përpiqet që të rigjenerojë vit pas viti përfitime të prekshme dhe të qëndrueshme për komunitetin në formën e shërbimeve të përmirësuara dhe të vëmendjes miqësore ndaj qytetarëve. Komuna punon që angazhimi qytetar, përgjegjshmëria, shërbimi ndaj qytetarëve të jenë të rrënjësura në mënyrat standarte me anë të të cilave komuna merr vendime të rëndësishme. Komuna Qendër punon gjithashtu të krijojë tek banorët besimin se ajo është e ndjeshme dhe reaguese ndaj nevojave dhe kërkesave të tyre.

79% e banorëve janë shumë të kënaqur dhe të kënaqur me aftësitë e stafit të komunës. 90% e banorëve e vlerësojnë mirë dhe shumë mirë ndershmërinë dhe drejtësinë me të cilat komuna merr vendimet. Komuna në çdo veprim të ndërmarrë synon të krijojë një lidhje të fortë besimi ndërmjet autoriteteve, banorëve, bizneseve, shoqatave etj. Si dhe të ofrojë një ambient mbështetës dhe të përshtatshëm.

I. Deklarata e vizionit

Komuna Qendër është treva e banorëve që bashkëjetojnë dhe punojnë në harmoni pavarësisht besimeve fetare dhe etnive në periferinë rrezëlluese të qytetit të Fierit me komplekse banimi moderne, me institucionet arsimore më të mira në rajon ku përgatiten fermerët dhe specialistët e bujqësisë, edukohet dhe arsimohet brezi i së ardhmes. Komuna Qendër është arterie kyçe e rrugëve automobilistike dhe hekurudhore kombëtare dhe lokale që lidhin Fierin me qytetet kryesore në Veri dhe Jug të Shqipërisë, me zonën industriale, me zonën prodhuese dhe bregdetin. Banorët dhe bizneset që gjallojnë në territorin e komunës sonë përfitojnë infrastrukturë dhe shërbime të standarteve më të larta. Komuna me stafin e saj dinamik dhe krijues i paraprin dhe nxit zhvillimin me studime, informacion dhe politika stimuluese.

II. Qëllimet Strategjike

Nr.	Zhvillimi Ekonomik	Zhvillimi Social	Zhvillimi i dhe Infrastrukturës Shërbimeve Publike	Qeverisja e Mirë
1.	Zhvillimi i sektorit të bujqësisë dhe blegtorisë	Zhvillimi i infrastrukturës shkollore dhe parashkollore	Përmirësimi urban i territorit të komunës	Rritja e nivelit të aftësive dhe cilësive të administratës dhe të zgjedhurve komunalë
2.	Zhvillimi i industrisë përpunuese të produkteve bujqësore dhe blegtorale	Zhvillimi i jetës kulturore dhe artistike dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe historike e zonës	Përmirësimi i sistemit rrugor që lidh qendrat e banuara	Arritja e standarteve të qeverisjes
3.	Zhvillimi i tregjeve dhe shoqatave të prodhuesve	Përmirësimi i jetës sociale të komunitetit	Përmirësimi i infrastrukturës së brendshme të fshatrave	Përmirësimi i dokumentacionit dhe proceseve që lidhen me tokën dhe pronësinë
4.	Zhvillimi i biznesit të vogël	Përmirësimi i shërbimit shëndetësor dhe higjienosanitar	Sigurimi dhe përmirësimi i furnizimit me ujë të pijshëm të popullsisë	Sigurimi i transparencës dhe llogaridhënies për menaxhimin e buxhetit të komunës
5.	Zhvillimi i arsimit të mesëm e të lartë profesional bujqësor	Rritja e nivelit të kulturës komunitare	Përmirësimi dhe shtimi i shërbimeve publike	Krijimi i qendrës administrative të komunës

QËLLIMI STRATEGJIK 1		Do të arrihet nëpërmjet		Kush?	Deri kur?	Kosto (Lek)	
Përshkrimi i Qëllimit Strategjik Zhvillimi i sektorit të bujqësisë dhe blegtorisë							
Hapat e Veprimit/Projektet							
Përmirësimi i sistemit të vaditjes dhe kullimit	<ul style="list-style-type: none"> Studim për vlerësimin e gjendjes fizike dhe të situatës së menaxhimit të sistemit vaditës dhe kullues (projekt) Përgatitja e një plani veprimi për vënien në funksionim dhe menaxhimin të sistemit vaditës dhe kullues (projekt) 	<ul style="list-style-type: none"> Studim për vlerësimin e gjendjes aktuale të rrugëve nëpër parcela dhe hartës së rrugëve nëpër parcela (projekt) Përgatitja e planit të ndërtimit të rrugëve dhe financimit (projekt) 	<ul style="list-style-type: none"> Ngritja e një laboratorit për kontrollin e produkteve bujqësore dhe blegtorale (projekt) Kontrolli i inputeve dhe produkteve bujqësore (shërbim) Këshillimi i fermerëve nëpërmjet specialistëve të bujqësisë dhe blegtorisë në komunë (shërbim) 	<ul style="list-style-type: none"> Ngritja e njësisë së orientimit dhe informacionit për fermerët në komunë (projekt) Ofrimi i informacionit për politikën e subvencionimit të sektorit të bujqësisë nga qeveria (shërbim) Asistencë nga komuna në përgatitjen e dokumentacionit për fermerët që duan të përfitojnë nga subvencionet (shërbim) 	<p>Komuna</p> <p>Komuniteti i fermerëve Specialistë Garku Fier Bordi i ujit Shoqatat e vaditjes</p> <p>Komuna</p> <p>Komuniteti i fermerëve Specialistë Garku Fier</p> <p>Komuna</p> <p>Komuniteti i fermerëve Specialistë Garku Fier Drejtoria e Bujqësisë</p> <p>Komuna</p> <p>Komuniteti i fermerëve Specialistë Garku Fier Drejtoria e Bujqësisë</p>	<p>2015</p> <p>Në vazhdimësi</p> <p>Në vazhdimësi</p> <p>Në vazhdimësi</p>	<p>Kosto studimi 1,000,000lek</p> <p>Kosto studimi 1,000,000lek</p> <p>10,000,000lek</p> <p>10,000,000lek</p>
Përmirësimi i infrastrukturës rrugore nëpër parcela							
Përmirësimi i kontrollit dhe shërbimeve agroteknike dhe veterinare							
Përmirësimi i informacionit për fermerët							

